



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 664/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 16.10.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a”, me nr. REF-32878-08-06-2019, me fond limit 126,736,606 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.08.2019, nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k.  
Adresa: Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

**Autoriteti kontraktor:** OSHEE sh.a.  
Adresa: Blv. “Gjergj Fishta”, Nd. 88, H.1, 1023, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.08.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a*”, me nr. REF-32878-08-06-2019, me fond limit 126,736,606 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.08.2019, nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

II.2. Në datën 13.08.2019, operatori ekonomik ankimues “Kristalina - KH” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Konkretisht: Se pari: kërkojme ndarjen në lote të kësaj procedure shtypshkrimeve me vete dhe kancelarite me vete, sepse Autoriteti i ka publikuar si një procedure prokurimi për të dyja produktet. Objekti i procedureve është “Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a” dhe është përcaktuar procedure e hapur për mallra pra objekti kryesor është blerja e mallrave dmth e kancelarive. Në ligjin e prokurimit publik neni 1 pika 2 përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet

procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;” Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “5.Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor”. Ne ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 3 përcaktohet: “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen, në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.” Ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikues nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në një procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit. Ne mendojme dhe gjykojme se artikujt e kancelarive si skoc, usb, korrektor stilolaps, marker permanent, maja portamine, portamin, laps, stilolaps, tela makiner 24/6, makine qepese, kapëse aktesh, ndares dokumentash, shënjes per firmosje, skoc transparent, ngjites stick, dosje kartoni me llastik, dosje kartoni me buton, dosje arkive me mekanizem, bllok shënimesh etj (e gjithë lista e kancelarive) duke qene se jane mallra kancelari ato nuk hyjne ne grupin e shtypshkrimeve te cilat do te prokuroje autoriteti kontraktor. Kancelarite mund të prokurohen në një lot më vetë në mënyrë që të zgjerohet rrethi i pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Mendojmë se në rastin konkret, mosndarja në Lote nga autoriteti kontraktor e procedurës së prokurimit zvogëlon numrin e shoqërive që do të shfaqin interes për këtë procedurë prokurimi, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar të tyre. Pra, autoriteti kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me frymën e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke mos e ndarë procedurën në fjalë në lote të veçanta për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik si organi me i larte ne fushen e prokurimeve per raste te ngjashme per ndarjen ne lote, ndaj kerkojme qe Autoriteti te pranoje ankesen tone dhe te beje ndarjen ne lote me qellim nxitjen e pjesemarrjes dhe mos kufizimin e saj ne kete procedure prokurimi.

Se dyti: Ne piken 2.3.4 operatori ekonomik duhet te kete te punesuar ne nr. mesatar jo me pak se 10 punonjes per 12 muajt e fundit. Nga llogarite tona na rezulton per makinat e shperndarjes nevojiten 10 vete. Per realizimin ne kohe te kontrates tek makinat e shtypit qe ju keni kerkuar nevojiten rreth 15 persona.

Se treti: Kerkojme te modifikohet kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.5. te kriterëve te vecanta per kualifikim te shtojces ku eshte kerkuar si me poshte: 2.3.5. Operatori ekonomik per materialet shtypshkrime duhet te disponoje:

-Makineri shtypi offset me minimalisht 2 (dy) ngjyra dhe format minimal 70 x 100cm

-Makineri palosje format 70 x 100

-Makineri per numerator

-Makineri per mbledhjen automatike te letres kimike

-Binder per ngjitjen e kopertinave

-Makine qepese me tel

-Pajisje CTP per parapergatitje per shtyp

Ne shtojcen 9 te specifikimeve teknike te DST-se rezulton se artikujt qe kerkojne te prokurohen kane te dhena teknike si blloqe, regjistra, formate A5 (14x20)cm, A4 (21x29.7)cm, formati 25x35 cm, formate A3 (29.7x 42)cm ose formate 30x42 cm. Pra formati me i madh eshte 30x42 cm te percaktuar ne specifikimet teknike ku ne disa artikuj eshte me i madhi. Ne keto kushte kerkojme nga autoriteti kontraktor qe formati minimal i makines se shtypit te jete 2C me permasa minimale 30x 40 cm po ashtu i makines se palosjes 30x42 cm. Ne keto kushte makina 70x100 cm 2C mund te zevendesohet me dy makineri 50x70 cm 2C ose makineri 50x70 cm me me shume ngjyra si 4C etj. Po ashtu makina e palosjes 70 x100 cm mund te zevendesohet me dy makina 50x70 cm.

Operatori ekonomik per te vertetuar disponimin e pajisjeve te mesiperme duhet te paraqese dokumentacionin ne nje nga format e meposhtme: Kontrate shitblerje/ ose Fature shitblerje, ose Kontrate huaperdorje, ose Kontrate qiramarrje, ose -Kontrata e dhurimit, ose te deklaruar ne bilancin e vitit 2018. Ne rast se posedon makinerine/te me qira ose huaperdorje, duhet te paraqese kontraten e qirase ose huaperdorjes te lidhur para noterit me afat kohezgjatje minimalisht sa kohezgjatje e afatit te kontrates objekt prokurimi. Autoriteti kontraktor ne cdo rast i lind e drejta te verifikoje disponimin e makinerive prane ambienteve te ofertuesit. Shoqeria jone gjykon se ky kriter eshte itepert, diskriminues dhe jo ne perputhje me objektin e prokurimit dhe natyren e kesaj kontrate. Ne vendimin per rregullat e prokurimit publik te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 eshte percaktuar qe autoriteti kontraktor mund te kerkoje makineri per procedurat e prokurimit sherbime e pune, qe nderkohe kjo procedure eshte publikuar nga autoriteti si kontrate blerje malli, por gjithnje ato duhet te jene ne perputhje me objektin dhe natyren e kontrates qe prokurohet. Ne kete rast autoriteti kontraktor per materialet shtypshkrime ka kerkuar makineri dhe disponimi i tyre te vertetohet me disa menyra si kontrate shitblerje, fature, ose kontrate huaperdorje ose kontrate qiramarrje ose kontrate dhurimi ose te deklaruar ne bilancin e vitit 2018. Kriteri i percaktuar per makinerite qe te jene ne bilancin e vitit 2018 eshte kriter diskriminues sepse nuk mund te vertetohet disponimi i makinerive me nje fakt te tille, psh per makinerite e blera gjate vitit 2019 nuk mund te vertetohen ne bilancin e vitit paraardhes 2018 dhe keshtu operatoret ekonomike nuk vihen ne kushte barazie ne lidhje me disponimin e mjeteve. Mjetet e blera gjate vitit 2019 nuk ka mundesi llogjike dhe mundesi reale te pasqyrohen ne bilancin e vitit 2018, pra percaktimi i ketij kriteri per mjetet qe keto te jene te deklaruar ne bilancin e vitit 2018 nuk pasqyron gjendjen apo disponimin real te mjeteve, si dhe nese keto mjete jane te deklaruar ne bilancin e vitit 2018 prape nuk tregon disponimin e mjeteve ne kohen aktuale kur zhvillohet tenderi sepse pronesia e tyre mund te jete ndryshuar gjate ketij viti ne vijim. Duke qene nje kriter jo i detyrueshem per tu permbushur ne rastet kur mjetet jane blere ne vitin 2019 dhe OE nuk ka pasur mundesi dhe nuk mundet realisht te pasqyrohen keto mjete ne bilancin e vitit 2018 qe ketu fillon fakti qe ky kriter eshte diskriminues

*dhe i tepert dhe si kriter i tille duhet te hiqet duke lene vetem ato kriteret qe perputhen me objektin e prokurimit dhe qe ve ne kushte te barabarta krahasimi te gjihe operatoret ekonomike te interesuar. Vertetimi i disponimit te mjeteve eshte mese i mjaftueshme te vertetohet me kontrata shitblerje, fatura, kontrate qiraje, huaperdorje, dhurimi. Si perfundim kerkojme te hiqet nga kriteri 2.3.5 kriteri qe mjetet te jene te deklaruar ne bilancin e vitit 2018.[...]*”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, me anë të shkresës nr.17423/3prot., datë 14.08.2019, duke e pranuar pjesërisht atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

*“Përsa i përket pikës së parë të ankesës Tuaj, ku pretendoni se kjo procedurë duhet të ndahet në lote, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor ka përzgjedhur këtë procedurë bazuar në eksperiencat e tij të mëparshme dhe duke parë që në treg janë një numër i madh Operatorësh që i ofrojnë këto mallra. Pra në lidhje me këtë pikë pretendimi Juaj nuk qëndron.*

*Përsa i përket pikës së dytë të ankesës Tuaj, ku pretendoni për një rritje të fuqisë punëtore, ju sqarojmë se AK referuar eksperiencave të tij të mëparshme, makinerive të kërkuara si edhe kohëzgjatjes së kontratës vlerëson se një punësim mesatar prej 10 punonjësish është mëse i mjaftueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Pra në lidhje me këtë pikë pretendimi Juaj nuk qëndron.*

*Përsa i përket pikës së tretë të ankesës Tuaj, ku pretendoni ndryshimin e formatit të makinerive që kërkohen, ju sqarojmë si në rastin e mësipërm të fuqisë punëtore, formatet e kërkuara të këtyre makinerive, garantojnë realizimin në kohë dhe me sukses së kontratës, pra pretendimi nuk qëndron.*

*Përsa i përket pikës së katërt të ankesës Tuaj, ku pretendoni mbi një nga mënyrat e disponimit të makinerive të kërkuara me qëllim realizimin e shtypshkrimeve sipas së cilit ato duhet të jenë të deklaruar në bilancin e vitit 2018, ju bëjmë me dije se ky pretendim qëndron dhe AK do të bëjë ndryshimet përkatëse.”*

II.4.Në datën 23.08.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.Në datën 04.09.2019, nëpërmjet shkresës me nr.18067/1prot., datë 02.09.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për ndarjen në lote të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Se pari: kerkojme ndarjen ne lote te kesaj procedure shtypshkrimet me vete dhe kancelarite me vete, sepse Autoriteti i ka publikuar si nje procedure prokurimi per te dyja produktet. Objekti i procedures eshte “Blerje kancelari dhe shtypshkrime per nevojat e shoqerise OSHEE sha” dhe eshte percaktuar procedure e hapur per mallra pra objekti kryesor eshte blerja e mallrave dmth e kancelarive. Ne ligjin e prokurimit publik neni 1 pika 2 percakton: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;” Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “5.Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor”. Ne ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 3 përcaktohet: “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen, në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.” Ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikues nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në një procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit. Ne mendojme dhe gjykojme se artikujt e kancelarive si skoc, usb, korrektor stilolaps, marker permanent, maja portamine, portamin, laps, stilolaps, tela makiner 24/6, makine qepese, kapëse aktesh, ndares dokumentash, shënjues per firmosje, skoc transparent, ngjites stick, dosje kartoni me llastik, dosje kartoni me buton, dosje arkive me mekanizem, bllok shënimesh etj (e gjithë lista e kancelarive) duke qene se jane mallra kancelari ato nuk hyjne ne grupin e shtypshkrimeve te cilat do te prokuroje autoriteti kontraktor. Kancelarite mund të prokurohen në një lot më vetë në mënyrë që të zgjerohet rrethi i pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Mendojmë se në rastin konkret, mosndarja në Lote nga autoriteti kontraktor e procedurës së prokurimit zvogëlon numrin e shoqërive që do të*

*shfaqin interes për këtë procedurë prokurimi, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar të tyre.”*  
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 prashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”*

III.1.2. Në nenin 9, pika 5 e të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.”*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimit, KPP konstaton se objekti i këtij prokurimi është blerja e artikujve kancelarik të cilat, për të përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor duhet të realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, si dhe blerjen e artikujve të ndryshëm dhe standartë kancelarik.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankimuesit, një lot artikujt standart kancelarik dhe një lot artikujt kancelarik të cilat realizohen nëpërmjet shtypshkrimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb të gjithë artikujt objekt prokurimi i përkasin të njëjtës kategorie produktesh. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Se dyti: Ne piken 2.3.4 operatori ekonomik duhet te kete te punesuar ne nr. mesatar jo me pak se 10 punonjes per 12 muajt e fundit. Nga llogarite tona na rezulton per makinat e shperndarjes nevojiten 10 vete. Per realizimin ne kohe te kontrates tek makinat e shtypit qe ju keni kerkuar nevojiten rreth 15 persona.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.9, pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar nje numer mesatar jo me pak se 10 (dhjete) punonjes per 12 muajt e fundit.*

*Per te permbushur kete kerkese, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesvete leshuar nga Administrata Tatimore qe verteton se subjekti ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per 12 muajt e fundit, e shoqeruar edhe me listepagesat e paraqitura ne organet tatimore per 12 muajt e fundit”*

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.2.3. Përsa i takon kërkesës të ankimuesit në ankesën e paraqitur pranë Komisioni të Prokurimit Publik, ku kërkon që të shtohet numri mesatar i punonjësve për 12 muajt e fundit, nga 10 në 25 të tillë, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kjo kërkesë në thelb ka të bëjë me shtim kriteri. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor, apo një kriteri kufizues apo të ekzgjeruar, por mbi shtimin e kriterit kualifikues në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në këtë kuptim, KPP gjykon se, në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Për këtë arsye ky pretendim nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “Se treti: Kërkojme të modifikohet kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5. të kriterëve të vecanta për kualifikim të shtojcës ku është kërkuar si më poshtë: 2.3.5. Operatori ekonomik për materialet shtypshkrime duhet të disponojë:

-Makineri shtypi offset me minimalisht 2 (dy) ngjyra dhe format minimal 70 x 100cm

-Makineri palosje format 70 x 100

-Makineri për numerator

-Makineri për mbledhjen automatike të letres kimike

-Binder për ngjitjen e kopertinave

-Makinë qepese me tel

-Pajisje CTP për parapergatitje për shtyp

Në shtojcën 9 të specifikimeve teknike të DST-se rezulton se artikujt që kërkojnë të prokurohen kanë të dhëna teknike si blloqe, regjistra, formate A5 (14x20)cm, A4 (21x29.7)cm, formati 25x35 cm, formate A3 (29.7x 42)cm ose formate 30x42 cm. Për formati më i madh është 30x42 cm të përcaktuar në specifikimet teknike ku në disa artikuj është më i madhi. Në keto kushte kërkojme nga autoriteti kontraktor që formati minimal i makines së shtypit të jetë 2C me përmasa minimale 30x 40 cm po ashtu i makines së palosjes 30x42 cm. Në keto kushte makina 70x100 cm 2C mund të zëvendësohet me dy makineri 50x70 cm 2C ose makineri 50x70 cm me shumë ngjyra si 4C etj. Po ashtu makina e palosjes 70 x100 cm mund të zëvendësohet me dy makina 50x70 cm” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.9, pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, i ndryshuar me shtojcën përkatëse, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

” 2.3.5 Operatori ekonomik për materialet shtypshkrime duhet të disponojë:

•Makineri shtypi offset me minimalisht 2 (dy) ngjyra dhe format minimal 70 x 100 cm

•Makineri palosje format 70 x 100

•Makineri për numerator

•Makineri për mbledhjen automatike të letres kimike

•Binder për ngjitjen e kopertinave

•Makinë qepëse me tel,

•Pajisje CTP për parapergatitje për shtyp

Operatori ekonomik për të vertetuar disponimin e pajisjeve të mesiperme duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

-Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose

-Kontrate huapërdorje, ose

-Kontrate qiramarrje, ose

-kontrata e dhurimit

Në rast se posedon makinerinë/te me qira ose huapërdorje, duhet të paraqesë kontratën e qirase ose huapërdorjes të lidhur për noterit me afat kohezgjatje minimalisht sa kohezgjatja e afatit të kontratës objekt prokurimi.

Autoriteti kontraktor në çdo rast i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive pranë ambienteve të ofertuesit”

III.3.2.Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.3.3.Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këtë kontekst, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e domosdoshme që të sigurohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës, disponojnë mjetet e nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se, në zbatim të kontratës objekt prokurimi, shfaqet i nevojshëm disponimi i pajisjeve, e cila duhet të disponojë parametrat minimale për të prodhuar me sukses mallrat objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Por, Komisioni gjykon se, përcaktimi i përmasave minimale të formatit që duhet të disponojë makineria shtypit dhe makineria e palosjes “70 cm x 100 cm”, është jo në përputhje me volumin e kontratës objekt prokurimi, si dhe i pajustifikuar nga autoriteti kontraktor, pasi në specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, në mënyrë të qartë dhe të saktë përcaktohen përmasa, të cilat janë më pak se 70 cm x 100 cm. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke caktuar përmasat minimale të makinerive të mësipërme në përputhje me specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina - KH” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqërisë OSHEE sh.a”, me nr. REF-32878-08-06-2019, me fond limit 126,736,606 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.08.2019, nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kristalina - KH” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1428 Protokoli, Datë 23.08.2019**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**